



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 19/1 prot.

Tiranë më 12.1.2018

Lënda: Mendim mbi projektligjin "Për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme".

Z. Fatmir XHAFAJ

MINISTËR I BRENDSHËM

Tiranë

I nderuar Z. Xhafaj,

Në përgjigje të shkresës Tuaj nr. 9900/1, datë 08.01.2018, projektligji "Për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", në tërësi vlerësohet i hartuar konform ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Vlerësojmë se pika 6 e nenit 3 të projektligjit, nuk duhet të jetë për shkak se rastet e kufizimit të të drejtës për informim janë të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Me qëllim garantimin e parimit të privatësisë, sugjerojmë që pas pikës 7, të nenit 50, të shtohet një pikë 8 me këtë përmbajtje: "Anëtarët e organeve të vlerësimit që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë duke mos keqpërdorur këtë informacion si gjatë edhe pas përfundimit të funksioneve duke nënshkruar edhe deklaratatën përkatëse të konfidencialitetit sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale".

Në funksion të natyrës së veprimtarisë që do të ushtrojë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, ku i gjithë procesi do të përfshijë përpunim të dhënash, por edhe interesit për transparencë, me qëllim garantimin sa më të mirë të tyre. Zyra e Komisionerit shpreh gatishmërinë për të dhënë kontributin e saj me një anëtar pranë këtij Komisioni. Në këtë rast do të ishte i nevojshëm riformulimi përkatës në nenin 6 të projektligjit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

